



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 08/ Prot
1

Tiranë, më 05/02.2015

URDHËR

Nr. 01 datë 05/02 2015

Mbështetur në Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë Nr.52/2014, "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Nr.106/2014, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetimit Administrativ në ngarkim të kontrolluesit "Stock International Albania" sh.a, Tiranë.

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit Nr.223, datë 07/12/2014 të Komisionerit pranë kontrolluesit "Stock International Albania" sh.a. Tiranë, është zhvilluar kontroll administrativ me objekt:

➤ Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e kontrollit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të kontrollit vëren se:

1. Kontrolluesi "Stock International Albania" sh.a., nuk ka përmbushur detyrimin ligjor, që rrjedh nga neni 21 dhe 22 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, për depozitimin e Formularit të Njoftimit, pranë Autoritetit të Komisionerit.
2. Kontrolluesi "Stock International Albania" sh.a., nuk realizon detyrimin për informim të subjektit të të dhënave personale, (në momentin e kontaktimit telefonik, ruajtjen e regjistrimit të bisedës së realizuar dhe ruajtjen e përmbajtjes së saj, etj), dhe nuk zbaton mekanizmin e marrjes së pëlqimit me shkrim për subjektet e të dhënave personale të kategorisë "klient",

duke cënuar të drejtën e ligjshme të individit, të parashikuar në nenin 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

3. Kontrolluesi nuk ka rregulla, në lidhje me identifikimin e kategorisë së subjekteve të të dhënave “klient”. Identifikimi i subjekteve të të dhënave “klient” dhe kontaktimi me këta të fundit, realizohet në mënyra jo të përcaktuara qartë dhe të pambështetura në dokumenta ligjore konkrete duke realizuar në këtë mënyrë, përpunim jo të drejtë dhe jo të ligjshëm të të dhënave personale. Kontrolluesi nuk vendosi në dispozicion të grupit të kontrollit administrativ asnjë dokumentacion që të legjitimonte këtë përpunim të dhënash personale dhe nuk vendosi në dispozicion të Zyrës së Komisionerit një dokumentacion të tillë edhe pas zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 19/01/2015. Ka një grumbullim dhe përpunim të dhënash personale të konsiderueshme të subjekteve në mënyrën jo të ligjshme dhe duke shkelur parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave personale, dhe konkretisht nenet 5-6 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
4. Kontrolluesi “**Stock International Albania**” sh.a, nuk ka të përcaktuara rregulla për mbledhjen, përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet video-survejjimit (regjistrim me kamera CCTV), gjë kjo, që bie ndesh me nenin 18, 27 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
5. Kontrolluesi “**Stock International Albania**” sh.a., realizon shkëmbim të dhënash personale, (emër, mbiemër, dokumente të skanuara etj), nëpërmjet platformës elektronike që ka në përdorim me kompaninë mëmë, ACECAP Investment Limited, në Qipro, pa patur një akt/dokument që të legjitimojë shkëmbimin e informacionit personal ndërmjet palëve, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale, duke shkelur kështu, në mënyrë flagrante nenin 8 dhe 20 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.
6. Kontrolluesi “**Stock International Albania**” sh.a., me publikimin e “Politikat e Privatësisë” në faqen online të tij, nuk ka përputhshmëri dhe nuk reflekton kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave personale”, i ndryshuar

Këto konstatime, konsiderohen në shkelje dhe mosrespektim të kushteve dhe kriterëve që parashikon, Ligji Nr. 9887, datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Neni 30, paragrafi 1, gërma“b”e ligjit të sipërcituar përcakton se: “Komisioneri ka këto të drejta:
b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 5, 6, 8, 18, 20, 21, 22, 27,28 ,29, 30 32 dhe 39 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Kontrolluesi "**Stock International Albania**" sh.a, të realizojë në mënyrë të menjëhershme, pezullimin e përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, kategoria "*klient*".
2. Kryerjen e seleksionimit të të dhënave për kategorinë e subjekteve "*klient*", klasifikimin dhe verifikimin e saktë të tyre si:
 - * Të dhëna personale të siguruara në rrugë të drejtë e ligjore, dhe,
 - * **Të dhëna personale të siguruara në mënyrë jo të drejtë dhe të paligjshme.**
3. Kontrolluesi "**Stock International Albania**" sh.a, pasi të ketë vepruar sipas pikës 2 të këtij urdhri, të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale të siguruara në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme, brenda një afati 7 (shtatë) ditor.
4. Kontrolluesi, mbart detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër.
5. Kontrolluesi, pasi të realizojë detyrimin për të njoftuar Zyrën e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me zbatimin e detyrave të lëna në këtë urdhër, do i nënshtrohet një verifikimi nga ana e grupit të kontrollit administrativ.
6. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion administrativ me gjobë dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky urdhër u shpall sot më 05.02 2015

